

UPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-85/12

Prishtinë,
17 shtator 2013

Në çështjen juridike të

A. S.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

Rr. B.

Pala Përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/138/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA50277) i datës 07 dhjetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 shtator 2013, morri këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e A. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/138/2011, i datës 07 dhjetor 2011, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA50277.
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/138/2011, i datës 07 dhjetor 2011, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me Nr. KPA50277.
- 3- Pala ankuese duhet t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 30 tetor 2007, A.S. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që t'i kthehet në shfrytëzim banesa-podrumi, që gjendet në Prishtinë, në rrugën "Ramiz Sadiku", në Prishtinë. Posedimin pretendohet të ketë humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1998/99.

Për të mbështetur pretendimin e tij, ai ka paraqitur aktvendimin e Sekretariatit për Urbanizëm, dhe për Çështje Komunale-Banesore, numër 07. Nr. 360-253, i datës 26 janar 1994 në Prishtinë.

Njoftimi i banesës është bërë me 24 korrik 2008.

Me 14 gusht 2008, pala përgjegjëse në kërkesë ka pretenduar të drejtën e tij në këtë banesë, me ç'rast ka paraqitur këto dëshmi:

- Vendimin e Komisionit për ndarjen e banesave të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë, numër 337, i datës 01 shtator 1990;
- Vendimin e Pleqësisë së Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë, numër 337/2, i datës 25 tetor 1990.

Sipas këtyre vendimeve palës përgjegjëse në kërkesë i është dhënë t në shfrytëzim banesa-podrumi, që gjendet në Prishtinë, në rruga Ramiz Sadiku, numër 28.

Më herët, posedimi i banesës së përmendur me lokacion në Prishtinë, rruga Ramiz Sadiku, ishte objekt shqyrtimi dhe vendosjeje e Komisionit për Çështje Pronësore Banesore (KÇPB). Komisioni me vendimin e tij HPCC/D/221/2005/A&C, ka refuzuar kërkesën e kategorisë A të Rr. B. ndërsa kategorinë C të kërkesës së pranuar të A. S. në kërkesat me numrat DS004261 dhe DS601196. Mbi bazën e kërkesës për shqyrtim të Rr. B. dhe T. K., me vendimin HPCC/REC/88/2007, të datës 19 janar 2007, kërkesa e kategorisë A është hedhë dhe referuar në gjykatat e rregullta dhe kërkesa e kategorisë C me Nr. DS601196 ishte hedhë poshtë gjithashtu. Vendimi është bazuar në argumentimin që për kërkesën e kategorisë C paraqitësi i kërkesës nuk ka provuar se se ai kishte ndonjë të drejtë pronësore mbi banesën-përdhës të kërkuar. Në vendimin e saj, KÇPB-ja thekson se pala e parë kërkuese Rr. B. pohon faktin se atij i ishte dhënë banesa në vitin 1990 por ai ishte penguar në lidhjen e kontratës për shkak të përkatësisë etnike shqiptare dhe diskriminimit për shkak të kësaj, përderisa pala e dytë kërkuese T. K, si bartës i të drejtës banesore (punëdhënësi), pretendon se asnjëherë nuk i është lëshuar vendim A. S. –it, me të cilin atij i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të pronës së kërkuar meqë ai nuk ishte i punësuar aty. Më tutje vendimi i referohet faktit se në mbështetje të pretendimit të tij T.K. ka paraqitur procesverbalin në të cilin ishte regjistruar se paraqitësi i kërkesa e kategorisë C (A. S.) shfrytëzonte pronën pa kurfarë baze ligjore. KÇB-ja, gjithashtu theksonte se Drejtoria ishte munduar por pa sukses që të verifikonte vendimin i cili ishte lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm i Kuvendit Komunal që i lejonte paraqitësit të kërkesës së kategorisë C të shfrytëzonte pronën.

Kërkesa tjetër e paraqitur nga A. S. këtë here pranë Agjencionit Kosovar të Pronës (AKP-ës) e regjistruar me numër 50277, ishte hedhur me vendimin KPCC/D/R/138/2011, i dates 07 dhjetor 2011, bazuar në arsyetimin se vendimi paraprak i Komisionit për Çështje Pronësore Banesore HPCC/REC/88/2007, i dates 19 janar 2007 ishte çështje e gjykuar për palët.

Vendimi i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës me date 31 qershor 2012.

Me 3 maj 2012, vendimi i KKPK-ës i ishte dorëzuar pales përgjegjëse në kërkesë.

Më 24 gusht 2012, paraqitësi i kërkesës (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese), ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin me pretendimin se ishte shkelur ligji material dhe për shkak të aplikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar plotësimin e vendimit të ankimuar dhe njohjen e të drejtës së posedimit në banesën-përdhës.

Me 5 shtator 2012, ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë e cila nuk kishte paraqitur përgjigje në ankesë.

Arsyetim ligjor

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, vendimit ankimor si dhe pretendimeve të palës ankuese, gjeti se ankesa është e pabazuar.

KPKK-ja ka vepruar drejtë kur ka hedhur kërkesën e A. S.mbi bazën se çështja kontestuese paraqitet si *res judicata* midis palëve të njejta. E njejta çështje veç ishte gjykuar me vendimin HPCC/REC/88/2007, i dates 19 janar 2007, para se kjo kërkesë ishte paraqitur. Me vendimin e sipërcekur, KÇPB-ja, kishte hedhur kërkesën paraprake për shkak se A.S. nuk kishte provuar se ai kishte ndonjë të drejtë pronësore mbi banesën-përdhese. Pa marrë parasysh termin e përdorur nga KÇPB-ja si “hedhje”, Gjykata Supreme vëren se arsyetimi ligjor i këtij vendimi i referohet shqyrtimit të kërkesës e cila veç është refuzuar. Ky lloj vendimi paraqet gjykimin përfundimtar në meritat e kërkesës. Prandaj, paraqitësi i kërkesës nuk mund të lejoj që kërkesa e njejte e tij të jetë objekt trajtimi si çështje e njejte midis palëve të njejta, për të cilën ai që më parë nuk mund të prezentoj prova valide përderisa te pretendohen dhe provohen ekzistimi i kushteve për mjete të jashtëzakonshme

Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KPKK-ës ishte i drejtë mbrenda kufijve të jurisdiksionit dhe kompetencave të KPKK-ës të parapara me nenin 11.4 c të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2006/50, e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, dhe se duhet vërtetohet.

Bazuar në mbi të mësipërmen dhe sipas nenit 13.3.b të Rregullores Nr. 2006/50, e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe nenin 166, paragraf 2, i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, u vendo si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e

KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2) : 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që humb rastin. Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë për personin me vendbanim jashtë vendit është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet përmbarimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva - Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it